



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 196/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Nenad Laziç dhe Afijete Sada - Gllgjani anëtarë, dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Urim Grajqevci nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Obiliq, paraqitur kundër koalicionit IRDDNJSP, dega në Obiliq, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit i mbajtur me datë 12.06.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa Anr 196/2017 i datës 11.06.2017 parashtruar nga Urim Grajqevci nga rradhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Obiliq.

### **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 11 qershor 2017, nga Urim Grajqevci nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Obiliq, paraqitur kundër koalicionit IRDDNJSP dega në Obiliq, me të cilën parashtruesi i ankesës pretendon se në shumicën e vendotimeve VV në Obiliq, të gjithë vëzhguesit me këtë akronim janë deklaruar se janë anëtarë të subjekteve politike Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lëvizjes për Bashkim (LB).

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Me ankesën e parashtruar nga Urim Grajqevci, në cilësinë e zyrtarit nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Obiliq ku pretendohet se në shumicën e vendotimeve VV në Obiliq, gjatë kohës së procesit të votimit, të gjithë vëzhguesit me këtë akronim janë deklaruar se janë anëtarë të subjekteve politike PDK dhe LB.

PZAP-i vlerësoi se pohimet e ankuesit janë të pa argumentuara, pasi që nuk janë të dëshmuara me asnjë provë relevante, për të vërtetuar dhe vendosur lidhur me pretendimet ankimore në favor të parashtruesit të ankesës.

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

Anr.196/2017 i datës 12.06.2017



**Kryesuesi i Panelit  
Faton Ademi**

*Faton Ademi*

***Këshillë Juridike :***

*Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 i LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*